

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shënoi në Wembley dhe udhëhoqi Spanjën, Lamine Yamal kërkon kurorën e futbollit botëror. Katalanasit këmbëngulin për "Topin e Artë"
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/28/shenoi-ne-wembley-dhe-udhehoqi-spanjen-lamine-yamal-ke-rkon-kuroren-e-futbollit-boteror-katalanasit-kembengulin-per-topin-e-arte/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:38:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	28 shtator 2026, 07:37:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 28 shtator 2026, 07:36:00 UTC → 28 shtator 2026, 07:38:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9d3922053ea7e0c22cdba91c8c0e5fd21bf865ad32ca52ee7f75ef1c0649046
TEKSTI	d86bebfc1e27de3e36ca3f5eed330e00692c9a55a50c3e1adc4b611984b31c5a
PAMJA	6c8f9c1732a0378e341e975f2c72b63a388679e70ef3afe5ec4f4c5c8dc8e771

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e07c53972b5e32fd2db2603b602cb302d01a6ee652cf1db3b4b5be88a66fb96c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f736abde33fe298fdab4b0ac01389ddc82e49c4df4ee1e7f323305e5a671536d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e07c53972b5e32fd2db2603b602cb302d01a6ee652cf1db3b4b5be88a66fb96c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL LA LIGA SPORT TË FUNDIT

Shënoi në Wembley dhe udhëhoqi Spanjën, Lamine Yamal kërkon kurorën e futbollit botëror. Katalanasit këmbëngulin për "Topin e Artë"

28/09/2026 09:37



Të detyrosh Anglinë të dorëzohet në Wembley, pasi shënon një gol dhe bëhesh një prej protagonistëve kryesorë të fitores 2-3 të Spanjës në Nations League, është një tjetër dëshmi e nivelit të jashtëzakonshëm të Lamine Yamal.

Edhe pse kjo ndeshje nuk do të merret në konsideratë për votimin e Topit të Artë 2025-26, rezultatet e saj treguan edhe një herë se 19-vjeçari tashmë është një prej emrave më të rëndësishëm të futbollit botëror.

Yamal po merr përsipër përgjegjësi që zakonisht u takojnë futbollistëve me shumë më tepër eksperiencë. Kandidatura e tij nuk mbështetet vetëm te golat, asistet apo trofetë, por edhe te aftësia për të vendosur ndeshjet, për të krijuar raste dhe për të shkëlqyer në sfidat e nivelit më të lartë.

Këtë e ka bërë si me fanellën e Barcelonës, ashtu edhe me atë të kombëtares spanjolle. Në edicionin e kaluar, Yamal e mbylli garën për Topin e Artë në vendin e dytë, pas Ousmane Dembélé, i cili në atë kohë luante për Paris Saint-Germain.

Një sezon i jashtëzakonshëm me Barcelonën

Në sezonin 2025-26, i cili merret në konsideratë për çmimin prestigjioz, Yamal fitoi me Barcelonën La Ligën dhe Superkupën e Spanjës, ndërsa skuadra katalanase arriti deri në çerekfinalin e Champions League dhe gjysmëfinalin e Kupës së Mbretit.

Në kampionat, Yamal ishte një prej lojtarëve më kreativë dhe më vendimtarë të Barcelonës, duke u shpallur edhe Lojtari i Vitit në La Liga. Ai e përfundoi sezonin me 24 gola dhe 17 asistime në 45 ndeshje, duke regjistruar gjithsej 41 kontribute direkte në gola.

Në La Liga, 19-vjeçari shënoi 16 gola, rekordi i tij personal në kampionat, duke ndarë Trofeun Zarra me shokun e skuadrës, Ferran Torres. Përveç golave, Yamal dha edhe 11 asistime, më shumë se çdo futbollist tjetër në kampionat.

Edhe më domethënëse është fakti se ai ishte vendimtar në 20 nga 26 ndeshjet e La Ligës që zhvilloi, duke shënuar, asistuar ose fituar penallti.

Edhe në Champions League, protagonist

Në Champions League, Yamal vazhdoi të ishte një prej lojtarëve më të rrezikshëm të Barcelonës. Ai shënoi 6 gola dhe dha 4 asistime, duke qenë protagonist në 8 nga 10 ndeshjet që zhvilloi. Në çerekfinale kundër Atlético Madridit, kur Barcelona duhej të përmbyste humbjen 0-2 të pësuar në ndeshjen e parë, Yamal shënoi golin që i dha shpresë skuadrës katalanase në fitoren 2-1 në Madrid.

SPORT • KRYESORE



Exclusive/ Nga dhoma e hotelit me Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe



Exclusive/ "Vajza e Baggios i vuri emrin Igli lepurit të saj", detaji i rrallë që tregon miqësinë e veçantë mes Tares dhe familjes së legjendës italiane



Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës



Exclusive/ "Bënte skemat me copa buke e pirunj", rrëfimi i Igli Tares për Guardiolën para se të bëhej trajneri i madh



Nuk është Ronaldo, nuk ka problem, Portugalia i imponohet Norvegjisë së Haaland

ME TË LEXUARAT

Exclusive/ Nga dhoma e hotelit me Guardiolën te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani, Igli Tare në një rrëfim ndryshe

UEFA vlerësoi gjithashtu paraqitjet e tij. Yamal u bë futbollisti më i ri në histori që arrin të paktën 10 gola dhe asistime në një edicion të vetëm të një kompeticioni europian, duke thyer rekordin e mëparshëm të vendosur nga Erling Haaland.

Botërori i dha një tjetër dimension kandidaturës së tij

Por ajo që e bën kandidaturën e Yamalit edhe më të veçantë është ajo që ka bërë me kombëtaren spanjolle. Yamal u shpall kampion bote, pasi Spanja mposhti Argjentinën e Lionel Messit në finale. Në këtë mënyrë, ai u bë futbollisti më i ri në histori që fiton si Kampionatin Europian, ashtu edhe Kupën e Botës, të dyja para se të mbushte 20 vjeç.

Gjatë Botërorit, Yamal shënoi golin e tij të parë ndaj Arabisë Saudite dhe u shpall lojtari i ndeshjes kundër Austrisë. Ai mori sërish çmimin e lojtarit të ndeshjes në çerekfinale ndaj Belgjikës, ku spikati me numrin e goditjeve, driblimeve dhe aksioneve të krijuara.

Yamal, një kandidat i ndërtuar mbi shumë dimensione

Kandidatura e Lamine Yamalit nuk mbështetet vetëm te statistikat. Ajo përfshin golat, asistimet, krijimtarinë, trofetë, driblimet, ndikimin në ndeshjet e mëdha dhe aftësinë për të ndryshuar rrjedhën e një takimi.

Në këtë aspekt, 19-vjeçari ka treguar se nuk është thjesht një talent i madh për të ardhmen. Ai tashmë po luan një rol vendimtar në ndeshjet më të rëndësishme, si me Barcelonën, ashtu edhe me Spanjën.

Dhe paraqitja e fundit në Wembley, ku shënoi dhe ndihmoi Spanjën të mposhtë Anglinë 2-3, ishte një tjetër kapitull në këtë histori.

Më 26 tetor 2026, në Londër, do të mësohet emri i fituesit të Topit të Artë. Yamal do të jetë sërish në qendër të vëmendjes, tashmë si një prej figurave kryesore të futbollit botëror.

Top Channel

Asnjë shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj, Irlanda e kthen ndeshjen me Izraelin në një deklaratë simbolike

Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

Exclusive/ "Vajza e Baggios i vuri emrin Igli Iepurit të saj", detaji i rrallë që tregon miqësinë e veçantë mes Tares dhe familjes së legjendës italiane

Skandali në Beograd, provokimi shfaqet sërish, "Kosova është Serbi" në tribunat e Serbi-Holandë

Exclusive/ "Bënte skemat me copa buke e pirunj", rrëfimi i Igli Tares për Guardiolaën para se të bëhej trajneri i madh

Nuk është Ronaldo, nuk ka problem, Portugalia i imponohet Norvegjisë së Haaland

Kaos te Irlanda, Bazunu refuzon ndeshjen ndaj Izraelit, zgjidhja emergjente e stafit habit UEFA-n

Dush i ftohtë për Dardanët në Vjenë, Austria ndëshkon dy herë Kosovën në 45 minutat e para

Humbje e hidhur në Vjenë, Kosova mundet 3-1 nga Austria, goli i Zhegrovës nuk mjafton

I Futboll »



Portugalia, asnjë minutë për Ronaldo ndaj Norvegjisë, nuk ndodhte prej më shumë se 6000 ditësh

28/09 09:31



Nuk është Ronaldo, nuk ka problem, Portugalia i imponohet Norvegjisë së Haaland

27/09 22:47



Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

27/09 22:41



E turpshme në Milano/ Vandalizohet muralesi dedikuar Franco Baresit te selia e Milanit

27/09 22:00



Asnjë shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj, Irlanda e kthen ndeshjen me Izraelin në një deklaratë simbolike

27/09 21:54



Kosova, Franco Foda analizon humbjen: Goli i 2-0 ishte momenti që ndryshoi ndeshjen

27/09 21:22

I La Liga »



Dëmtimi delikat në gju i Kylian Mbappe, dalin përgjigjet e



Shqetësim i madh në Madrid/ Mbappe dëmtohet sërish në gjurin e



'FIFA duhet të reformohet për të mirën e futbollit'/ Ligat e mëdha

analizave: Ja kur rikthehet ylli i Real Madrid

26/09 18:59



Raphinha flet hapur: Dua Champions League, atë gjysmëfinale me Interin nuk e kapërdij dot

25/09 11:39

majte, ekzaminimet mbyajnë gjithçka në ajër

26/09 16:43



Rodri kujton sërisht merkaton: Real i Madridit tentoi me gjithçka kishte kishte për mua

23/09 23:21

evropiane kërkojnë norysnime në qeverinë e futbollit botëror

25/09 12:31



'Lufta e hapur' mes Javier Tebas dhe Realit të Madridit: Përsa kohë Florentino do të jetë në krye, raportet janë të pariparueshme

23/09 22:14

I Sport »



Portugalia, asnjë minutë për Ronaldon ndaj Norvegjisë, nuk ndodhte prej më shumë se 6000 ditësh

28/09 09:31



Nuk është Ronaldo, nuk ka problem, Portugalia i imponohet Norvegjisë së Haaland

27/09 22:47



Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

27/09 22:41



Exclusive/ "Bënte skemat me copa buke e pirunjt", rrëfimi i Igli Tares për Guardiolen para se të bëhej trajneri i madh

27/09 22:30



Exclusive/ "Vajza e Baggios i vuri emrin Igli lepurit të saj", detaji i rrallë që tregon miqësinë e veçantë mes Tares dhe familjes së legjendës italiane

27/09 22:02



E turpshme në Milano/ Vandalizohet muralesi dedikuar Franco Baresit te selia e Milanit

27/09 22:00

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Begaj mbledh Këshillin e Sigurisë, diskutohet situata në Shërbimin Informativ Shtetëror



Top Channel/ Tre operacione policore në 24 orë në Kukës, 3 në pranga, sekuestrohen armë dhe kanabis



Top Channel/ Shkarkimi i Vlora Hysenit, nis mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare



Top Channel/ Protesta e 120-të në Tiranë. Protestuesit: Vlora Hyseni do shpëtojë, e mbron Rama



Top Channel/ Alarm i kuq në Meksikë. Uragani "Polo" pritët të prekë tokën të hënën mbrëma



Top Channel/ Digjet në banesë i moshuari në Fier, 74-vjeçari ishte i paralizuar

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			
© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.					

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.